

K Ë R K E S Ë

GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR TË DIBRËS

KËRKUES: Sadulla Hazizi, i biri i Rushenit dhe i Nadires, i datëlindjes 1949, banues në qytetin e Peshkopisë, i martuar me 4 fëmijë.

Objekti: Shpalljen të zhdukur të shtetasit Belul Hazizi, në bazë të nenit 15 e vijues të Kodit Civil dhe të nenit 375 e vijues të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Më datën 9.3.1996 ka dalë nga shtëpia djali i xhaxhait im i quajtur Belul Hazizi, i cili është nisur së bashku me disa shokë në drejtim të Italisë, në mënyrë klandestine me anë të gomoneve. Që nga ajo kohë e deri më sot unë dhe të gjithë të afërmit e tij nuk kemi asnjë lajm apo dijeni për vendqëndrimin e tij. Për këtë unë jam interesuar dhe nëpërmjet organizatave joqeveritare si Kryqi i Kuq Shqiptar dhe tek organet e Ministrisë së Brendshme, si dhe nëpërmjet radios dhe televizionit, qoftë atij shqiptar dhe atij italian dhe përsëri nuk kam asnjë të dhënë për vendndodhjen e tij.

Gjithashtu janë interesuar dhe të gjithë të afërmit tanë për këtë problem dhe nuk kanë marrë asnjë dijeni për të.

KËRKUESI
Sadulla Hazizi